

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6367
E hënë, 19 korrik 2021
çmimi 0.40 €

ShBA-ja: Kosova, lidere në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit

FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

BEKIM JASHARI DHE SAMI LUSHTAKU KANË VENDOSUR TË KANDIDOJNË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË SKENDERAJT NË ZGJEDHJET LOKALE

FAQE 4-5

JASHARI DHE LUSHTAKU MATIN PËRKRAHJEN MË 17 TETOR



Zgjedhjet komunale në komunën e Skenderajt pritet të sjellin një nga garat më interesante më 17 tetor në Kosovë. Ish-kryetari i kësaj komune nga radhët e Partisë Demokratike të

Kosovës (PDK-së), Sami Lushtaku, dhe kryetari i tashëm, Bekim Jashari, kanë vendosur ta matin forcën e përkrahjes në garën për kryetar të Skenderajt. Lushtaku i PDK-së, i cili

disa herë ka fituar zgjedhjet lokale me rezultat të thellë dhe Jashari, i cili zgjedhjet e fundit i kishte fituar pa balotazh, kanë shprehur siguri se do të fitojnë në këto zgjedhje

HAPET NJË TJETËR VENDKALIM KUFITAR NË MES TË KOSOVËS DHE MAQEDONISË SË VERIUT

FAQE 3



Të dielën është hapur vendkalimi kufitar në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut në pikën Restelicë - Strazimir. Ky vendkalim thuhet se do të ndihmojë edhe më shumë në bashkëpunimin mes dy vendeve. Pika kufitare Restelicë - Strazimir është planifikuar të veprojë nga 18 korriku deri më 1 shtator të këtij viti, me orar pune nga ora 08:00 deri në orën 20:00

RRITET NUMRI I VIKTIMAVE NGA PËRMBYTJET NË EVROPË

FAQE 2



TURISTËT U KTHEHEN MALEVE TË KOSOVËS

F. 8

'PETROL COMPANY' HAP PIKËN E RE NË QYTETIN E VITISË

F. 8



SPORT

MILWAUKEE, NJË FITORE LARG HISTORISË

F. 14

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht--Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rritet numri i viktimave nga përmbytjet në Evropë

BERLIN, 18 KORRIK - Numri i viktimave nga përmbytjet e fundit në Evropë ka arritur në 193, njoftuan autoritetet më 18 korrik. Ndërkaq, dhjetëra persona vazhdojnë të jenë të zhdukur. “Ekziston frika që numri i viktimave do të rritet”, ka njoftuar policia në rajonin gjerman Rhineland-Palatinate. Në këtë deklaratë të policisë u tha se vetëm në këtë rajon 670 persona janë lënduar. Përveç katër shteteve të goditura më së keqi nga përmbytjet, Gjermania, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu, me përmbytje tani po përballen edhe Zvicra, Austria dhe Republika Çeke. Të paktën 156 persona kanë vdekur në Gjermani, në atë që është përshkruar si përmbytjet më të këqija në historinë e këtij shteti. Ndërkaq, numri i viktimave nga përmbytjet në Belgjikë ka arritur në 27. Të paktën një person është raportuar se ka humbur jetën në

Bavari të Gjermanisë, pranë kufirit me Austrinë, gjatë shirave të rrëmbyeshëm në natën ndërmjet 17 dhe 18 korrikut. Në Bavari është shpallur gjendje e jashtëzakonshme. “Shirat dhe stuhitë, fatkeqësisht, po shkaktojnë dëme të rënda në Austri”, ka pohuar kancelari austriak Sebastian Kurz. Kancelarja gjermane Angela Merkel planifikon që ta vizitojë qytetin Shuld më 18 korrik për të parë dëmet e shkaktuara dhe për t’i takuar të mbijetuarit. Presidenti gjerman Frank-Walter Steinmeier ka vizituar zonat e përmbytura më 17 korrik dhe bëri thirrje për ndihmë dhe donacione për viktimat e përmbytjeve. Ndërkaq shërbimet e trenit ndërmjet Gjermanisë dhe Republikës Çeke janë pezulluar për shkak të problemeve teknike “të shkaktuara nga kushtet e motit”. Zyrtarët thanë se linjat hekurudhore do ta rinisin punën



më vonë gjatë 18 korrikut. Shkalla e fatkeqësisë në Gjermani është bërë më e qartë teksa ushtarët, me makina të blinduara, po pastrojnë rrugët dhe inxhinierët po vlerësojnë se

cilat ndërtesa duhet të shemben. Në zona të tjera zhytësit kontrolluan shtëpitë dhe veturat e përmbytura. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka vizituar zonat e

përmbytura në Belgjikë dhe ka postuar në “Twitter” këtë mesazh: “Evropa është me ju”. Belgjika ka shpallur 20 korrikun ditë zie për t’i nderuar viktimat e përmbytjeve.

Kryeministri britanik do të vetizohet



LONDËR, 18 KORRIK - Kryeministri britanik Boris Johnson dhe ministri i tij i Financave, Rishi Sunak, do të vetizohen për të paktën dhjetë ditë, pas njoftimit se ata kanë pasur kontakt me një person të infektuar me koronavirus. Më herët, zyra e Johnsonit tha se ai dhe Sunak do të merrnin pjesë në pilotprogramin e qeverisë, që do t’u lejonte atyre që të punonin nga zyrat e tyre, kur personat e tjerë të përfundonin orarin e punës. Megjithatë, Johnsoni e ndryshoi këtë vendim vetëm tri

orë më vonë për shkak të kritikave të shumta. Zyra e Johnsonit më 18 korrik njoftoi se kryeministri dhe ministri i Financave kishin qenë në kontakt me një person të infektuar, por nuk zbuluan identitetin e këtij personi. Megjithatë, një ditë më herët, ministri i Shëndetësisë, Sajid Javid, njoftoi se është infektuar me Covid-19. “The Sunday Times” më herët ka raportuar se Johnsoni ka pasur një takim të gjatë me Javidin më 16 korrik. Johnson do

të izolohet në rezidencën e kryeministrit në Chequers. “Ai do të vazhdojë të mbajë takime nga larg”, tha një zëdhënës i Johnsonit, duke shtuar se ai nuk do të marrë pjesë në pilotprogramin e qeverisë. Edhe Sunak tha, po ashtu, se do të vetizohet për t’i shmangur perceptimet se “rregullat nuk janë të njëjta për të gjithë”. Qeveria britanike ka thënë se do të heqë pothuajse të gjitha masat kundër Covidit më 19 korrik pavarësisht se infektimet kanë filluar të rriten së fundmi.

Në BE më shumë të vaksinuar sesa në ShBA

BRUKSEL, 18 KORRIK - Bashkimi Evropian tejkaloj Shtetet e Bashkuara të Amerikës sa i përket normës të vaksinimit teksa Brukseli dhe Uashingtoni zyrtar po përballen me një valë të re të infektiveve, të shkaktuara nga varianti Delta i koronavirusit. Rreth 55.5 për qind e popullatës së përgjithshme të BE-së tashmë kanë marrë të paktën një dozë të vaksinës, krahasuar me 55.4 për qind në Shtetet e Bashkuara, thuhet në të dhënat e Our World in Data. “BE-ja gjatë kësaj jave ka tejkalluar ShBA-në si kontinent që ka administruar më së shumti doza të para (të vaksinës)”, tha komisioneri Thierry Breton. BE-ja ishte kritikuar në fillim të vitit për shkak të një fushate të

ngadaltë të vaksinimit. Ndërkaq ShBA-ja kishte pasur një nisje të vrullshme të fushatës së imunizimit por, së fundmi, vaksinimi është ngadalësuar kryesisht për shkak të hezitimit për të marrë vaksina. Pavarësisht prej numrit të lartë të të vaksinuarve në BE dhe ShBA, janë rritur shqetësimet për një valë të re të virusit, për shkak të variantit “Delta”, i cili është më ngjitës. Ekspertët shëndetësorë kanë thënë se rreziku kryesor është te personat e pavaksinuar. Mbi 99 për qind e vdekjeve nga Covid-19 dhe 97 për qind e hospitalizimeve janë në mesin e personave të pavaksinuar, thuhet në të dhënat e Qendrave Amerikane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve.

Infektimet në ShBA janë rritur dyfish në dy javët e fundit, ku në baza ditore janë regjistruar pothuajse 30 000 raste. Ndërkaq, në BE, autoritetet shëndetësore kanë paralajmëruar se blloku mund të goditet nga një valë e re e infektiveve në fillim të gushtit. Për shkak të një vale eventuale, shumë vende kanë ashpërsuar masat. Barcelona dhe qytete të tjera në verilindje të Spanjës kanë rikthyer masën e orës policore gjatë fundjavës, ndërkaq në Los Anxhelos gjatë kësaj jave u bë e detyrueshme mbajtja e maskave. Ndërkaq, në Francë, mbi 100 000 persona në disa qytete protestuan kundër masave të reja, që kërkojnë që qytetarët të vaksinohen nëse duan të kryejnë aktivitete të caktuara.



Hapet një tjetër vendkalim kufitar në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut

Të dielën është hapur vendkalimi kufitar në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut në pikën Restelicë - Strazmir. Ky vendkalim thuhet se do të ndihmojë edhe më shumë në bashkëpunimin mes dy vendeve. Pika kufitare Restelicë - Strazimir është planifikuar të veprojë nga 18 korriku deri më 1 shtator të këtij viti, me orë pune nga ora 08:00 deri në orën 20:00

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 KORRIK - Pika kufitare Restelicë - Strazimir do të jetë tani vendkalimi tjetër kufitar në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Ky vendkalim thuhet se do të ndihmojë edhe më shumë në bashkëpunimin mes të dyja

vendeve. Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se ky rajon kufitar gjithnjë ka kultivuar marrëdhënie të mira në mes të banorëve të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, duke theksuar se duhet angazhim për lehtësimin e jetës dhe veprimtarisë së tyre. "Si dy vende fqinje ne kemi marrëdhënie të

mira ndërshtetërore. Dy shtetet tona gëzojnë marrëdhënie historike, politike, ekonomike dhe kulturore të cilat e bëjnë të domosdoshëm bashkëpunimin tonë. Ky rajon ndërkufitar gjithmonë ka kultivuar marrëdhënie të veçanta në mes banorëve të dy vendeve. Bashkëjetesa e mirë e qytetarëve

tanë nga dy zonat, përkundër kufijve, na shtyn të angazhohemi për lehtësimin e jetës dhe veprimtarisë së tyre. Kjo do të hapë mundësi të reja të zhvillimit dhe bashkëpunimit në mes dy vendeve tona në sektorë të ndryshëm", ka thënë ai. Sveçla ka shtuar se do të jetë vigjilent dhe nuk do të lejojë që bashkëpunimi i mirë në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut të dëmtohet nga askush.

Në ceremoninë e hapjes së këtij vendkalimi i pranishëm ishte edhe ministri i Punëve të Brendshme të Maqedonisë së Veriut, Oliver Spasovski, i cili tha se bashkëpunimi me Ministrinë e

Punëve të Brendshme të Kosovës në kontrollin e vijës kufitare nga viti në vit shënon një përparim evident. "Siguria kufitare, së bashku me transferimin e lirë dhe të papenguar të mallrave dhe udhëtarëve përtej kufijve, janë objektivat kryesorë të sistemit të integruar të menaxhimit të kufirit, por edhe të bashkëpunimit rajonal dhe, mbi të gjitha, dypalësh kufitar", ka thënë Spasovski, duke shtuar se Maqedonia e Veriut mbetet e hapur për të gjitha iniciativat, programet, aktivitetet rajonale dhe evropiane që janë në interes të të gjithë qytetarëve të këtij shteti, por edhe të qytetarëve të rajonit dhe lagjes.



Jashari: Masakrat mbi popullin shqiptar, dëshmia më e mirë e gjenocidit serb në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

SKENDERAJ, 18 KORRIK - Kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka qenë i pranishëm në konferencën "Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare 1912-1999", organizuar nga shoqata "Trojet e Arbrit". Me këtë rast, Jashari ka thënë se numri i madh i masakrave të tmerrshme mbi popullin e pafajshëm shqiptar janë dëshmia më e mirë e gjenocidit dhe krimeve makabre që shteti serb ka bërë mbi ne. "Numri i madh i masakrave të tmerrshme mbi popullin e pafajshëm shqiptar janë dëshmia

më e mirë e gjenocidit dhe krimeve makabre që shteti serb bëri mbi ne me dekada, për të cilat ende kriminelët dhe shteti serb nuk janë dënuar", ka deklaruar Jashari. Ai ka shtuar se nga ana tjetër këto masakra shpërfaqin sakrificën e jashtëzakonshme të popullit tonë për liri e pavarësi.

Kryetari Jashari ka thënë se është obligim i secilit nga ne, por edhe më shumë i historianëve e studiuesve tanë që të mbledhim, faktojnë e argumentojnë luftën tonë të drejtë për çlirimin e vendit në njërin anë dhe, në anën tjetër, të dëshmojnë krimet që shteti serb bëri pamëshirshëm në Kosovë.

Shtatë raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i

Shëndetësisë Publike i Kosovës, prej 2 202 testimeve të brëra, shtatë qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i të vdekurit. Të dielën janë shënuar edhe dy qytetarë, derisa numri i

përgjithshëm i të shënuarve është 105 536. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 103.





BEKIM JASHARI DHE SAMI LUSHTAKU KANË VENDOSUR TË KANDIDOJNË
PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË SKENDERAJT NË ZGJEDHJET LOKALE

Jashari dhe Lushtaku matin përkrahjen më 17 tetor

Zgjedhjet komunale në komunën e Skenderajt pritet të sjellin një nga garat më interesante më 17 tetor në Kosovë. Ish-kryetari i kësaj komune nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së), Sami Lushtaku, dhe kryetari i tashëm, Bekim Jashari, kanë vendosur t'i matin forcat në garën për kryetar të Skenderajt. Lushtaku i PDK-së, i cili disa herë ka fituar zgjedhjet lokale me rezultat të thellë dhe Jashari që zgjedhjet e fundit i kishte fituar pa balotazh, kanë shprehur siguri se do të fitojnë në këto zgjedhje

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 18 KORRIK - Zgjedhjet lokale të 17 tetorit pritet të sjellin një garë interesante në mes të shumë kandidatëve që do të garojnë për kryetar të komunave të Kosovës. Një garë e tillë, sipas të gjitha gjasave, do të jetë edhe në

Skenderaj, në të cilën do të konkurrojnë për kryetar të kësaj komune ish-kryetari Sami Lushtaku nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe kryetari aktual Bekim Jashari, kandidat i pavarur.

Bastionin e PDK-së në Skenderaj, Lushtaku e ka udhëhequr për disa mandate, duke fituar me rezultat

të thellë, kurse kryetari aktual Bekim Jashari, i cili mandatin e kishte fituar me mbështetjen e PDK-së, beson se do të arrijë ta mposhtë Lushtakun.

Lushtaku dhe Jashari, të cilët vijnë nga i njëjti fshat, Prekaz, kanë paralajmëruar se shumë shpejt do t'i zyrtarizojnë kandidaturat e tyre. Në profilin e tij në "Facebook",

Sami Lushtaku ka shkruar se kandidaturën do ta paraqesë sot (e hënë) me një ceremoni zyrtare. "Të dashur miq, ju ftoj që të hënë, më 19 korrik 2021, në orën 19:00, në restorantin 'Atlantic' në Skenderaj, ta zyrtarizojmë kandidaturën time për kryetar të komunës së Skenderajt për zgjedhjet lokale të 17 tetorit", ka shkruar Lushtaku.

Kurse kryetari aktual i komunës, Bekim Jashari, ka bërë me dije se kësaj gare do t'i hyjë pas kërkesave të shumta të qytetarëve. "Katër vjet më parë mora një vendim jo të lehtë për mua dhe familjen time. Inkuadrimi im në jetën politike në rrethanat në të cilat po kalonte shteti ynë nuk ishte i lehtë, por duke qenë pjesë e jetës në

komunën tonë, duke parë problemet dhe sfidat e mëdha me të cilat po ballafaqohej komuna jonë, duke qenë i vendosur për t'i shërbyer vendit tim dhe qytetarëve pa asnjë dallim, me kërkesë të qytetarëve pranova të kandidoj për kryetar të komunës sonë në zgjedhjet lokale të vitit 2017", ka shkruar Jashari në profilin e tij në "Facebook".

Në reagimin e tij, ai ka treguar për punën që ka bërë gjatë këtij mandati. "Përkrahja juaj plebishitare për mua dhe qeverisjen time ishte obligimi imi që të punoj me përkushtim maksimal për një jetë më të mirë për secilin qytetar të komunës sonë, për çka i jam falënderues përjetë secilit prej jush. Qeverisjen

Bahtiri thotë se në raundin e parë do t'i fitojë zgjedhjet në Mitrovicë me 65 për qind

MITROVICË, 18 KORRIK (ER) - Kryetari aktual i komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thënë se më 17 tetor do të fitojë në raundin e parë me 65 për qind. "Asnjë 'sondazh' imagjinar e anonim nuk

mund të na ndalë për fitoren me 65% + që në raundin e parë", ka shkruar Bahtiri në llogarinë e vet në "Facebook". Bahtiri i ka bërë thirrje opozitës që të bëhen bashkë se nëse garojnë veç e veç

rezultati i tyre do të jetë për keqardhje. "Njëkohësisht, e ftoj gjithë opozitën në Mitrovicë të bëhet bashkë sepse, nëse garojnë veç e veç, rezultati i tyre do të jetë për keqardhje", ka shkruar Bahtiri.



time lokale në udhëheqje të qytetarëve të Skenderajt e fillova me betimin që bëra pranë varreve të familjarëve të mi, gjyshit Shaban Jashari, komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jasharit, babushit Hamëzes dhe dëshmorëve të kombit në Kompleksin Memorial të Dëshmorëve në Marinë”, ka shkruar ai.

Më tej, Jashari ka shkruar se gjatë qeverisjes së tij u është përmbajtur premtimeve parazgjedhore. “Siç e dini, gjatë fushatës parazgjedhore të vetmin premtim që kam dhënë ka qenë qeverisja transparente dhe me duar të pastra falë bashkëpunimit që kemi ndërtuar dhe me përkrahjen edhe të nivelit qendror dhe donatorëve kemi arritur që, krahas instalimit të një

qeverisje që në qendër ka qytetarin, respektimin e shprehjes së lirë e mendimit ndryshe, kemi arritur të realizojmë shumë projekte infrastrukturore në shumë fusha dhe reforma në administratë që kanë ndikuar në avancimin e shërbimeve për qytetarët”, ka shkruar kryetari Jashari, duke shtuar se çdoherë ka qenë afër qytetarëve. “Gjatë mandatit tim qeverisës, së bashku me donatorë dhe qeverinë qendrore, kemi arritur të bëjmë me ujë të pijshëm 12 fshatra, kurse në proces e sipër i kemi edhe 12 të tjera. Për të pasur furnizim të rregullt me ujë të pijshëm këtë vit fillon projekti milionësh i ndërtimit të baseneve në Brus dhe ndërtimi i gypit kryesor me

kapacitet të madh, Brus - Skenderaj. Për këtë projekt si komunë kemi kryer procesin e shpronësimit të pronave”, ka treguar ai.

Gjithashtu, Bekim Jashari ka përmendur edhe disa nga punët që i ka bërë gjatë qeverisjes së tij. “Krahas kësaj, jemi në rrugë të drejtë për fillimin e realizimit të projektit tonë strategjik, ndërtimin e pendës së Kuqicës, që do të sigurojë ujë të pijshëm, ujitje për bujqësi dhe mundësi të zhvillimit të turizmit në vendin tonë. Kemi bërë investime infrastrukturore në institucionet tona shëndetësore si dhe furnizim me pajisje e medikamente të nevojshme mjekësore. Me qëllim të përkrahjes së grave lehona që nga

fillimi i këtij viti kemi filluar ndarjen e subvencioneve me nga 100 euro për secilën lindje”, ka shkruar Jashari.

Komuna e Skenderajt njihet si bastioni më i fortë i PDK-së, ku kjo parti zgjedhjet lokale dhe nacionale i ka fituar me rezultat të thellë. Mirëpo, para katër vjetëve, kur Bekim Jashari, djali i heroit Hamëz Jashari, kishte vendosur të kandidojë për kryetar të komunës, PDK-ja ishte tërhequr nga gara, duke mos vendosur kandidat të saj për kryetar. Madje PDK-ja kishte dalë hapur në mbështetje të Bekim Jasharit. Pas marrjes së mandatit, Jashari kishte filluar t'i kritikonte asamblistët e PDK-së dhe Lushtakun për obstrukcione ndaj tij.

Më pas, Jashari e Lushtaku ishin përfshirë në polemika të forta, duke e akuzuar njëri-tjetrin. Edhe për zgjedhjet e 17 tetorit të këtij viti ishte menduar se të dy kandidatët do ta nxjerrin një kandidat të tretë për kryetar të Skenderajt. Madje kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, i cili njihet si njeri i afërt me Bekim Jasharin, ishte shprehur i bindur se Lushtaku dhe Jashari do të gjejnë gjuhë të përbashkët për këtë çështje. Së fundi, mediat lokale kanë raportuar se Lushtaku dhe Jashari janë takuar disa herë për ta gjetur një kandidat të përbashkët. Mirëpo, si duket këto takime nuk kanë pasur sukses, dhe Lushtaku e Jashari kanë vendosur t'i futen garës për kryetar të komunës.



Haradinaj, Kurtit: Dikur veç unë të quaja mashtrues, tash numri është shumë i madh

PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka shpërndarë të dielën një videoincizim në faqen e tij në “Facebook”, ku shihet kryeministri Albin Kurti në një televizion të Shqipërisë, duke kundërshtuar taksën që duhet paguar prej 5 eurosh për të hyrë në Shqipëri.

“Dikur e kundërshtojte ashpër taksën e Rrugës së Kombit dhe unë atëherë isha me ty! Por ti nuk paske qenë i sinqertë, sepse ndryshe nuk kishe vendosur që shtresës së mesme të popullit, e për hesap të oligarkëve, me ia marrë edhe nga 5 euro nga xhepi. Edhe kjo ‘nalepnica jote’ ka mundur të kushtojë 1 euro, por ti paske hesape të

tjera”, ka shkruar Haradinaj. Ai ka shtuar se: “Dikur veç unë të quaja mashtrues e tani numri atyre që të cilësojnë si mashtrues është tepër i madh! Zbrit në tokë o kryeministër se shteti nuk udhëhiqet me llafe, sado të bukura qofshin ato, por me punë! E ju çdo punë po e keni të ligë, siç e ligë është edhe kjo hajnia prej 5 eurosh!”.



Lutfi Haziri rikandidon edhe për një mandat për kryetar të Gjilanit

GJILAN, 18 KORRIK (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka zyrtarizuar rikandidimin e Lutfi Hazirit edhe për një mandat

katërvjeçar për komunën e Gjilanit. "Luta ka ditur dhe di t'i dalë Zot këtij vendi. Di t'u qëndrojë afër qytetarëve të këtij vendi, ka ditur të mbajë afër

gjeneratat më të vjetra dhe të afrojtë të rinjtë, t'i avancojë gratë në pozita të merituar e t'u japë shanse të barabarta vajzave të reja. Luta është udhëheqës

shembullor, njeri shembullor i LDK-së. Luta ka vendosur shembuj të shumtë se si udhëhiqet komuna", ka thënë Abdixhiku.



Përfundon renovimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Karaçevë

KAMENICË, 18 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me drejtorin e Humanity First për Ballkan, Zubair Khalil, koordinatoren e kësaj organizate për Kosovë, Jinahuddin Saif, ushtruesin e detyrës së drejtorit të Qendrës Kryesore Familjare në Kamenicë, Besim Beqiraj, si dhe zyrtarë të tjerë komunalë bënë përfundimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Karaçevë. I pari i komunës, Qëndron Kastrati, ka thënë se bashkë me bashkëpunëtorët po bëjnë të pamundurën për përmirësimin e kushteve infrastrukturore në institucionet e shëndetësisë dhe arsimit. "Pas renovimit dhe investimit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Karaçevë, sot bëjmë përfundimin bashkë me drejtorin e Humanity First për Ballkan, Zubair Khalil, koordinatoren e kësaj organizate për Kosovë, Jinahuddin Saif, si dhe

kolegët nga komuna. Me bashkëpunëtorët tanë po bëjmë të pamundurën për përmirësimin e kushteve infrastrukturore në institucionet shëndetësore dhe arsimore", ka deklaruar ai. Kastrati ka shtuar se, gjithashtu, vizituan edhe shkollën fillore "Rexhep Mala", ku bashkërisht financuan laboratorin dhe kabinetin e IT teknologjisë. "Gjithashtu, vizitua edhe shkollën fillore 'Rexhep Mala', në Topanicë, ku bashkërisht financuam në laboratorin dhe kabinetin e IT teknologjisë. Falënderoj shumë Premtim Fazliun për kontributin dhe angazhimin në këto dy projekte tejet të rëndësishme, si dhe Humanity First për bashkëpunimin", ka thënë Kastrati. Ky projekt për renovimin dhe riinvestimin e QMF-së në fshatin Karaçevë ka kushtuar afërsisht një euro.



Prokuroria Themelore në Pejë identifikon dy serbët që u panë në Deçan para helmimit të qytetarëve

PEJË, 18 KORRIK (ER) - Prokuroria Themelore në Pejë ka njoftuar lidhur me situatën e krijuar ditët e fundit në komunën e Deçanit pasi janë pranuar informata se para disa ditësh janë parë duke lëvizur në drejtim të Manastirit të Deçanit, dy persona të nacionalitetit serb, menjëherë janë ndërmarrë veprime me autorizimin e kryeprokurorit të

Prokurorisë Themelore të Pejës në koordinim me Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (AKI) dhe Drejtorinë Rajonale të Policisë së Kosovës në Pejë, ashtu që është bërë identifikimi i personave që shihen në ato fotografi dhe do të verifikohet nëse kanë lidhshmëri eventuale me situatën e krijuar ditët e fundit në komunën e Deçanit.

Helmimet në Deçan, Ramosaj thotë se situata po normalizohet

DEÇAN, 18 KORRIK (ER) - Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka mbajtur takimin e radhës me Shtabin Emergjent për menaxhimin e Emergjencave, në të cilin takim është vlerësuar situata e krijuar ditët e fundit rreth helmimit në këtë komunë. Ai ka thënë se situata me helmim po shkon drejt normalizimit.

"Aktorët e kyçur në menaxhimin e kësaj emergjence do të vazhdojnë implementimin e të gjitha rekomandimeve të dhëna nga IKShPK-ja, të cilat kanë të bëjnë me standardizimin e infrastrukturës së ujësjellësit dhe furnizimin me ujë cilësor sipas parametrevë të pranueshme", ka thënë Ramosaj.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) në analizat e bëra ka dalë se në ujën e pijshëm në këtë komunë janë gjetur vlera të shtuara të baktereve koliforme dhe E.coli. Sipas të dhënave nga komuna e Deçanit, 1 392 persona kanë kërkuar ndihmë në Qendrën e Mjekësisë Familjare.



ShBA-ja: Kosova, lidere në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit

PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Shtetet e Bashkuara e kanë përgëzuar Kosovën për riadhesimin e shtetasve të saj nga zonat e konfliktit në Siri, duke thënë se Kosova është lidere në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit. Të shtunën, më 17 korrik, Kosova riadhesoi 11 shtetas

nga zonat e konfliktit në Siri. "Kthimi i këtyre shtetasve demonstroi vullnetin e Kosovës që të marrë përgjegjësi për shtetasit e saj, teksa vendos shembull edhe për të tjerët. Kosova është lidere në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit", thuhet në një postim në

"Twitter" të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Të shtunën ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, tha se me kthimin e shtetasve të saj nga Siria, Kosova kryen përgjegjësitë ndaj qytetarëve të saj, por edhe ndaj Koalicionit Global për mposhtjen e grupit militant Shteti Islamik.



Kuvendi sot mban seancë, në rend dite 15 pika për shqyrtim

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 KORRIK - Sot (e hënë), në orën 10:00, Kuvendi i Kosovës do të mbajë seancë plenare. Në këtë seancë janë të paraparë 15 pika për shqyrtim. Në mesin e këtyre pikave është votimi i Projektligjit për ratifikimin e amendamentit të marrëveshjes ndërkombëtare me Bankën Evropiane për Investime (BEI) për financimin e Projektit për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10, i cili dështoi të miratohet të premten që lamë pas.

Pastaj do të jetë shqyrtimi i Projektligjit për amendamentimin 02 të Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e bashkëpunimit për zhvillim "KSV/017: Programi për mbështetje shëndetësore (pjesa II). Shqyrtimi i Projektligjit për

ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim për zbatimin e Projektit "Hulumtimi dhe shkencat e aplikuar në arsimin e lartë + (HERAS+) (ada numri referues 8116-00-2020)".

Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e amendamentit nr. 1 të Marrëveshjes kornizë së kredisë të datës 14 gusht 2020 ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Zhvillim të Këshillit të Evropës për financimin e projektit "Reagimi Emergjent ndaj Covid-19". Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave. Votimi i kërkesës së Komisionit për Bujqësi,



Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë për ndryshimin e emërimit të këtij komisioni. Zgjedhja e tre anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

nga radhët e komuniteteve joshumicë. Propozim-rezoluta nga debati parlamentar për zbatimin e Marrëveshjes së Uashingtonit. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes

Demokratike të Kosovës për zëvendësimin e anëtarit në komision parlamentar dhe shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2020.

Realizohen gjashtë ekstradime me Francën, Zvicrën, Gjermaninë, Italinë dhe Belgjikën



EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 KORRIK - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije se gjatë dy javëve të fundit janë realizuar gjashtë ekstradime me Francën, Zvicrën, Gjermaninë, Italinë dhe Belgjikën.

Haxhiu ka shkruar në llogarinë e saj në "Facebook" se përmes realizimit të këtyre ekstradimeve, personat e kërkuar për vepra penale do të ballafaqohen me procedurë penale ose do ta vuajnë dënimin e shqiptuar nga autoritetet gjyqësore. "Për më shumë, të mërkurën në

mbledhjen e Qeverisë së Kosovës është miratuar Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale", ka shkruar ajo. Ministria Haxhiu ka theksuar se me ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji do të ketë ekstradime më të shpejta duke ngërthyer gjithmonë standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. "Ne mbetemi plotësisht të përkushtuar në luftimin e krimit transnacional dhe në ndërmarrjen e veprimeve të përcaktuara me rendin juridik të Kosovës", ka shkruar Haxhiu.

Nga 21-23 korriku Kuvendi hap dyert për bashkatdhetarët

PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - Nga 21 deri më 23 korrik në Kuvendin e Republikës së Kosovës mbahet aktiviteti "Kuvendi hap dyert për

bashkatdhetarët". Gjatë tri ditëve, nga ora 10:00 - 16:30, Kuvendi do të jetë i hapur dhe mirëpret të gjithë

bashkatdhetarët të cilët dëshirojnë ta vizitojnë ndërtesën e institucionit më të lartë legjislativ. Gjatë qëndrimit

në Kuvend vizitorët duhet t'u përmbahen masave anti-Covid, përkatësisht duhet të jenë të pajisur me maska.



Turistët u kthehen maleve të Kosovës

PRISHTINË, 18 KORRIK - Mëngjesin e së enjtes, më 15 korrik, Sharka Valentia nga Çekia dhe dy shoqet e saj filluan ecjen në bjeshkët e Rugovës. Të pajisura me mjetet e nevojshme për alpinizëm dhe të shoqëruara nga udhërrëfyesi Fatos Katazolli, që është pjesë e Unionit të Turizmit të Kosovës (UTK), ato janë duke shijuar bukuritë që ofron Rugova. "Pamjet janë mahnitëse dhe moti është i mirë", ka thënë Sharka Valentia për "Radion Evropa e Lirë". Kjo është hera e parë që ajo viziton Kosovën dhe thotë se nuk do të jetë e fundit. Përveç turizmit malor, ajo thotë se i intereson edhe kultura në Kosovë. "Ne kemi ardhur dje. Kemi vizituar Pejën. Jemi duke planifikuar të shkojmë në Prishtinë dhe në Prizren. Dëshirojmë të provojmë të gjitha ushqimet tradicionale që përgatiten këtu. Po kënaqemi. Është një vend i ri, i paeksploruar", ka thënë ajo.

Fatos Katazolli nga Unioni i

Turizmit të Kosovës çdo verë shoqëron turistët që vijnë nga vende të ndryshme të botës. Ai ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë", se numër më i madh i turistëve ka filluar të vërehet pasi Qeveria e Kosovës bëri lehtësimin e masave kundër Covid-19. Sipas tij, vitin e kaluar kompanitë turistike që merren kryesisht me turizëm malor nuk kanë punuar fare, pasi nuk kishte turistë për shkak të pandemisë së koronavirusit që kishte paralizuar këtë sektor. Ai ka treguar se këtë vit nuk kanë pritur numër kaq të madh të turistëve. "Një vit e gjysmë nuk kemi punuar. Tash ka rritje mjaft të madhe. Pritet tona kanë qenë për këtë vit që së paku 30 ose 40 për qind të vitit 2019 të vijnë por, siç po duket, nëse vazhdon kështu, do të kalojmë 50 për qind të turistëve që kemi pasur dy vjet më herët", ka thënë Katazolli.

Ai ka thënë se turistët që vijnë nga vende të ndryshme, përveç turizmit malor, janë të interesuar

edhe për kulturën në Kosovë. "Kryesisht për turizmin malor janë turistët nga Evropa Perëndimore, nga Gjermania, Anglia si dhe nga Amerika, derisa për turizëm malor janë nga vendet arabe", ka thënë ai.

Mungesa e turistëve mbylli shumë biznese në vitin 2020

Për dallim nga Peja dhe turizmi malor i saj, në kryeqytet e ndiejnë mungesën e turistëve. Jeton Latifi nga Prishtina ka pesë vjet që e ka hapur bujtinën e tij në qendër të Prishtinës, por thotë se vitin e kaluar biznesi i tij ka rrezikuar të mbyllet si pasojë e pandemisë nga Covid-19. "Vitin e kaluar u mbyllën kufijtë. Dihet si ka qenë situata katastrofale. Shumë biznese si i yni kanë falimentuar. Ne kemi mbijetuar me forcat tona, me vetëfinancim kemi mbuluar shpenzimet tona dhe na është dashur të marrim borxhe, kredi për

të mbijetuar. Sivjet shpresojmë se do të këndellet gradualisht", ka thënë Latifi.

Ai ka treguar se ndonëse masat janë liruar dhe qarkullimi i njerëzve është më i madh, puna me turistë ende nuk është e kënaqshme. "Në muajt e fundit vërehet një lëvizje e lehtë e turistëve, që është një numër i vogël i turistëve e që rrjedhimisht nuk është diçka që na ndihmon në të rikuperojmë dëmet që kemi pësuar vitin e kaluar", ka deklaruar Latifi.

"Radio Evropa e Lirë" ka tentuar të marrë një përgjigje nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, por zyrtarë të kësaj ministrie nuk kanë pranuar të flasin për çështjen e turizmit.

Turizmi i varur nga vaksina

Dëmet në turizmin ndërkombëtar, për shkak të pandemisë, mund të

shkaktojnë humbje të më shumë se 4 trilionë dollarëve në bruto-produktin e brendshëm, në nivel global për vitet 2020 dhe 2021, është thënë në një raport të publikuar më 30 qershor nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim. Humbjet vlerësohet se janë rezultat i efektit të drejtpërdrejtë që ka pasur pandemia në turizëm dhe në sektorët e lidhur me të.

Ky raport i prezantuar bashkë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Turizëm Botëror ka treguar se turizmi ndërkombëtar dhe sektorët e lidhur ngushtë me të janë përballur me humbje prej 2.4 trilionë dollarësh më 2020 për shkak të uljes së numrit të udhëtimeve të turistëve.

Humbje të ngjashme mund të raportohen edhe këtë vit, paralajmëron raporti, duke theksuar se rimëkëmbja e sektorit të turizmit do të varet nga shkalla e vaksinimit kundër koronavirusit në nivel botëror.



"Petrol Company" hap pikën e re në qytetin e Vitisë


PRISHTINË, 18 KORRIK (ER) - "Petrol Company" tani do të jetë afër qytetarëve të Vitisë, pas hapjes së pikës më të re të saj me çmime më të lira, duke garantuar kualitet të lartë si dhe duke ofruar shumë zbritje dhe shpërblime deri në jack pot

"banesë". Shkelzen Jusaj, pronar i "Petrol Company", ishte i pranishëm në hapje si dhe personalisht furnizoi me derivate klientin e parë të kësaj pike. Shumë qytetarë të Vitisë e mirëpritën hapjen e kësaj pike pasi që, sipas tyre, ishte shumë e nevojshme që

"Petrol Company" të jetë afër tyre dhe të sjellë derivate cilësore dhe çmime të lira. Të gjithë ata që dëshirojnë të furnizohen në pikën më të re të "Petrol Company" në qytetin e Vitisë mund ta gjejnë në rrugën e Preshevës.



Jeta shoqërore, dëshirat letrare, korrupsioni letrar



NORMAN MAILER

Një nga shprehjet më mizore në gjuhë është: Ata që munden bëjnë, ata që s'munden, mësojnë. Paralelja e kësaj mund të jetë: Ata që përfitojnë përvojë mësohen të jetojnë, përderisa ata që nuk munden, bëhen shkrimtarë.

Shprehja e dytë ka shumë më shumë të vërtetë sesa e para, që i biesë ka disa të vërteta aty. Natyrisht, shumë shkrimtarë të rinj e vënë veten në rrezik të madh për të përfituar të gjitha veset e një shkrimtari të mirë. Përderisa për të qenë më të vyer, veç sa për kurajën tuaj, asnjëri prej këtyre profesioneve nuk përbën një shkrimtar të suksesshëm: CEO, politikan, inxhinier, zyrtar sindikate, kirurg, pilot aeroplani, lojtar i mirë i shahut, prostitutë, kapiten anije, mësues, burokrat, mafioz, pimp, recidivist, mjek, rabin, aktor filmi, prift ose edhe murgeshë - asnjëri prej tyre nga këto profesione nuk ka nxjerrë një novelist të mirë që nga Lufta e Dytë Botërore.

Po çfarë t'u bëjmë shkrimtarëve fantazmë, kolaboracionistëve, ose redaktorëve me gjuhë të stërzgatur të cilët ende shkruajnë kujtimet e tyre në kaseta incizuese e që për nga natyra e thellë e të kuptuarit të letërsisë krijojnë masë të madhe pune me mund të madh - shumë prej pasqyrimeve të tilla sociale na vijnë në kujtesë nëpërmjet fotografive, imazheve të fantazmave, dukurive të tejdukshme që në rrethana normale na dalin më shumë të jenë vepra letrare, novela të shkruara nga përfaqësues sindikatash. Shumë e thjeshtë është kjo punë. Shkrimtarët rinë vetëm me shkrimtarë, sikurse inxhinierët që kongregojnë në të njëjtat klube fshatrash në rrethinat e Detroitit.

Paragjykimet mbi Detroitin vijnë e përforcohen më shumë dita-ditës nëse e marrim parasysh historinë pesëdhjetëvjeçare të aftësisë së akumuluar të saj, të cilat në kushte të ndryshme arriten të prodhojnë

vetura të kualitetit të dyshimtë. Injektivë është edhe fenomeni i letërsisë dhe vuajtjet që ka pësuar nga kjo endemi e pafund. Ne jemi shumë të vetëdijshëm për sensitivitetin ndaj atyre që janë sensitivë, por totalisht jemi injorantë për ata të fuqishmit dhe budallenjtë. Mbase njëri mund të jetë fatal nëse arrijmë që ta zhveshim atë nga ndërmarësit e jetës korporatiste, menaxhimi financiar si, për shembull, mafia dhe klasa punëtore që janë pjesë e lidërshiptit. Disa nga gazetarët hulumtues na kanë dërguar neve në belin e kësaj makinerie të ndytë por, mbase, edhe jo mjaftueshëm. Ne ende nuk i kuptojmë se si operojnë ata që janë brenda sistemit. Për shembull, ne ende nuk kemi kuptuar se në çfarë forme emocionale dihet një ditë mëngjesi një nga lojtarët mbrojtës të futbollit. Shumica prej këtyre lloj hulumtimeve gazetareske bëhen me qëllime ideologjike, për t'i kënaqur bazat e tyre ideologjike, racionale, ironiken, median liberale të orientuar te gjetja e fakteve. Pra, ne kemi një kulturë elementare të çrregulluar; atë të mungesës së informacionit të bollshëm për të cilat kemi nevojë në mënyrë që ta formojmë mendimin tonë përreth këtyre problemeve. Pa marrë parasysh sa lexojmë, ne ende nuk dimë se si funksionon bota. Njerëzit që punojnë në këtë drejtim, ata kurrë nuk shkruajnë për këto gjëra, për të na njoftuar a edukuar. Përderisa shkrimtarët që merren me këtë punë gjithmonë përfundojnë duke shkruar të verbuar për njerëzit që nuk shkruajnë, por që e dinë se si funksionon bota. Për shembull, ne nuk do të kishim pasur problem që ta konsultojmë një të shenjtë që të na mësojë më shumë në lidhje me shkencën kompjuterike, por kurrë ta bëjmë atë mbrapsht. Shumë nga të shenjtët, bishat, manjakët, mistikët dhe yjet e rokut - shkruhet për ta këto ditë, kryesisht nga gazetarët vizioni i të cilëve është i përshkuar nga

parametrat e brendshëm të shartuar. Paaftësia jonë që ta kuptojmë botën tonë përreth do të vazhdojë edhe më tej.

Duke qenë se jam novelist, unë dua të di çdo fjalë. Nuk jam shumë kaxhaxhi kur vjen puna te akumulimi i dijeve. Unë dua të di e të kuptoj nga të gjitha disiplinat dhe vetëm në rastet kur mendoj se temat janë të padurueshme atëherë unë nuk humbi shumë kohë me to. Përderisa kurrë s'e përjashtoj mundësinë e vetëkorrupsionit të pafajshëm kur njeriu has në informacione dhe dije të ndryshme, prapëseprapë mendoj se është shumë e rëndësishme të kuptojmë se si funksionon kjo botë. Problemi me shumë shkrimtarë të rinj është se ata nuk kanë përvojë të mjaftueshme jetësore. Për këtë arsye ata në mënyrë tendencioze zhvillojnë vese paranojake. Këto vese kurrë nuk mund ta zëvendësojnë realen, të vërtetën, përvojën dhe jetën e vërtetë. (Kështu pat konkluduar edhe Franz Kafka në veprat e veta). Për shembull, sa shumë pjesë të historisë sonë, asaj që na rrethon, është konspiracion; sa shumë prej kësaj historie është një pëshqjellim i pafund? Në mënyrë që ta kuptosh këtë, duhet të dish më mirë edhe më shumë për botën që na rrethon.

Kurrë nuk ua kisha rekomanduar shkrimtarëve të rinj që të jetojnë në plaketë e klasës së lartë dhe aristokratike, ato të establishmentit, sepse këto klasa mbytin krijimtarinë e shkrimtarit për arsye të normave dhe rregullave që ato i përcaktojnë vetes. Ekziston një refleksivitet i thellë në klasat e tilla. Ajo përshkruhet kështu: Nëse je njëri nga ne, atëherë nuk je gjë tjetër përpos një njeri i mërzitshëm (ose nëse ke shumë para dhe familje të pastër të pakorruptuar, atëherë gjërat janë ndryshe). Nëse je pakëz më i rebeluar, atëherë ajo botë do të dojë sepse e di shumë mirë se, në fund të fundit, ti do të jesh i mërzitshëm për rrethin. Dhe kështu ti përfundon jashtë kësaj klase. Por,

megjithatë, edhe po qe se je një rebel i tillë, ata do të shtyjnë ti respektohen rregullat e tyre, sepse ata e duan dëfrimin dhe iu duhesh atëherë kur u nevojitesh. Nëse vazhdon t'i pranosh dhe t'i përqafosh këto rregulla, atëherë ti do ta dëmtosh veten. Capote ishte një njeri i tillë. Ai i ndoqi rregullat e tyre deri kur u mërzi, pastaj i braktisi ata dhe ata e braktisën dhe ne të gjithë e dimë se çfarë ndodhi me të. Kosinski, edhe ky i njëjti, me të njëjtën veprim, u bë pjesë e tyre, por në fund u mërzi dhe ata e përzunë dhe ky vrau veten.

Më kujtohet shumë mirë kur kisha thënë në vitin 1958 se: "Unë jam i pridestnuar të krijoj një revolucion të vetëdijes kombëtare. Asgjë më shumë e asgjë më pak". Kam dështuar në atë mision. A po? Në atë kohë unë kisha menduar se unë i kisha librat që shumë pak njerëz i kishin. Po ashtu, kur kisha nevojën të dija edhe më shumë, unë shkruaja libra që në moshë të re, dhe besoja se shoqëria do të ndryshohet. Çfarë iluzionit i tmerrshëm. Tashti gjërat për të cilat kisha luftuar me vite e dekada kanë humbur vlerën e tyre. Merre për shembull letërsinë - që nga pjesa e dytë e shekullit të kaluar - është mposhtur krejt. E di që është diçka e tmerrshme për atë që them, por mos harroni që ta kuptoni rëndësinë e letërsisë, lexoni më shumë nga pjesa e dytë e shekullit XIX. Nëse vazhdohet me këtë ritëm, unë besoj se brenda njëqind vjetëve të ardhshëm novela do ta humbë rëndësinë e vet sikurse që dramat pesëstrofëshe të Ibsenit kanë humbur rëndësinë e tyre sot. Novelat do të bëhen vetëm kuriozitetet të çastit dhe shkrimi do të lë shumë për të dëshiruar. Për shembull, ku do të ishte Anglia sot pa Shekspirin ose Irlanda pa Xhejms Xhojsin ose Jetsin? Nëse sot më pyet se kush e mban titullarin e barabartë të këtyre më lart sot në Amerikë, unë them që është Madona. Disa vjet më herët të gjitha vajzat e reja të vendit një gjë vetëm donin - Madonën. Ajo

ishte shndërruar në modele të kombit. Madona ka bërë më shumë për feminizmin sesa të gjitha lëvizjet sociale feministe në botë.

Nganjëherë novelat shkruhen sepse disa elemente të saj paraqiten para syve si shumë të thella. Ato të prekin dhe të stimulojnë të shkruash. Prakjo është pjesë burimore, senti-mentale e krijimtarisë. Herëve të tjera shkrimtari shkruan libra sepse ekonomia personale ia imponon sepse, në fund të fundit, të gjithë duam të ushqehemi. Burrat e fortë nuk vallëzojnë është një nga këto novela që, pasi kisha përfunduar Mbrëmjet antike, isha i stërlodhur dhe nuk shkrova për dhjetë muaj. Në atë kohë sapo kisha prishur marrëdhëniet e mia me botuesin tim Little & Brown pasi që ishte shumë jomirënjohës për të gjitha ato njëmbëdhjetë vjet që kisha kaluar derisa e kisha përfunduar librin e fundit. U ndava me të. U çlirova. Por, megjithatë, unë i kisha borxh edhe një libër para përfundimit të kontratës. Ai filloi të më bëjë shumë presion derisa erdhëm në atë gjendje sa që më dha ultimatum - ose të shkruaja edhe një libër, ose unë do të duhej t'ia ktheja të gjitha paratë, rrogën e përmuajshme që ma paguante sipas kontratës. Problemi me këtë ultimatum ishte se unë isha zënë ngushtë. Po qe se e prishja kontratën dhe t'i ripaguaja, unë kurrë nuk kisha pas shans të paguaja atë borxh dhe do t'i mbetesh edhe më keq - shtetit, zyrës së taksave do t'i kisha mbetur edhe më shumë borxh. Kështu që vendosa që të shkruaj shpejt. Fillova të lexoj edhe libra të tjerë jo të mirëfilltë si, për shembull, librat e J. Verne's, Një dramë amerikane, G. K. Chesterton, Njeriu që quhej e enjte etj. Fillova të mendoj më seriozisht se çfarë novele të shkruaj. Të shkruaj diçka për Nju-Jorkun, ishte problem sepse unë nuk jetoja në NY. Duhej të isha aty që të shkruaja një tregim të mirë. Mbi të gjitha, unë i kisha veç dy muaj për ta përfunduar librin. Fillova të lutem shumë por, jo të shkruaj. Dikur, duke e lexuar G. K. Chesterton, m'u mbush mendja për stilin e të shkruarit dhe për zhanrin. Njëfarë kombinimi i fiksonit dhe horrorit e krimin. Më erdhi në mendje Burrat e fortë nuk vallëzojnë. Arrita ta përfundoj brenda gjashtëdhjetë ditëve. Stili nuk ishte edhe aq i mirë por, bënte. Ploti i novelës është pakëz si budalla dhe nuk duhet të merret seriozisht. Ironia e gjithë kësaj ishte se Little & Brown nuk ma pranoi botimin. Unë e botova te Random House sepse deshi fati që më bleu nga Little & Brown dhe m'i pagoi edhe borxhet që i kisha ndaj tij. Prej atëherë unë ende jam me botuesin tim Random House.

Besoj se tashmë jeni të gatshëm të dëgjoni më shumë në lidhje me peripecitë që shkrimtari vuan çdo ditë për të krijuar.

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia". © "Armagedoni". Përktheu: Emanuel Bajra)



INTERVISTË ME POETIN DHE PROFESORIN E LETËRSISË SHQIPE, SALI BASHOTA (3)

NË KRIJIMTARINË TIME KA MË SHUMË TEMA TË DHIMBJES

BISEDOL: BERAT ARMAGEDONI

Çfarë mund të thoni për librat tuaj me prozë poetike?

Në librin e tretë, *Plagomë* (1994), të cilën ua kam kushtuar tri vajzave të mia, Albulenës, Besianës dhe Doruntinës, në mesin e shumë poezive, pothuajse të gjitha me rimë, janë edhe nëntë proza poetike: *Liri me gjarpër në gj*, *Forma artistike e lirisë*, *Java e shqipshkrimdhembjekrijimit*, *Kafshimi*, *Publiku me duar të lidhura*, *Kukuvajkat*, *Gjiri*, *Zogjtë e therur* dhe *Ndoshta është blasfemi*. Pastaj, në secilën vepër timen me poezi është i pranishëm nga një cikël me proza poetike, derisa e botova veprën e parë me proza poetike *Ëndrra në parajsë* (2006), pastaj veprat e

tjera me radhë, siç janë: *Sytë e vetmisë* (2010), *Rruzullimi i zjarrit* (2011), *Zemërimi i heshtjes* (2014), *Shkallët e natës* (2020).

Përmes prozës poetike synoj të shënjoj një cak tjetër, diçka midis poezisë dhe prozës. Atë që nuk e kam thënë në librat e mi me poezi, jam përpjekur ta artikuloj në prozën poetike. Jo rrallë më duket vetja se jam midis dy lumenjve, për të provuar se në cilin lumë do të notoj më shumë, por edhe më mirë. Fundja, nuk mund të bëj krahasime, prandaj poezia dhe proza poetike, pothuajse, janë i njëjti kërkim imi, i paraqitur në variante të ndryshme, ngjitur nëpër shkallët e imagjinatës, por edhe nëpër shkallët e jetës.

A mund të ketë proza poetike mesazh, kuptim dhe domethënie tjetër?

Ky është një lloj shqetësimi

krijues që më ka nxitur ta kuptoj përbrenda vetes një teori të komunikimit, por edhe një teori të receptimit për të, duke provuar "një zgjatje të kujtesës", siç do të thoshte Borhesi, edhe për ligjërimin, ritmin dhe figurat. Nga cilët faktorë do të përcaktohej gjuha metaforike (poezia) që të bëhej gjuhë e rrëfimit (proza). Në fakt, parimet krijuese besoj se shkojnë në të njëjtin drejtim, me një ndryshim të vogël që proza poetike mund ta funksionalizojë fabulën. Me prozën poetike jam përpjekur të rrëfej ngjarje dhe të përshkruaj situata.

Ndjenja juaj kur veprat tuaja filluan të përktheheshin në gjuhë të huaja?

Ndjenjë e bukur dhe ndryshim në krijimtarinë tënde letrare përbën përkthimi saqë të duket se po hyn në një botë tjetër që të

bashkëbisedosh në shumë gjuhë për ta përmbushur pasionin krijues për afirmimin e punës tënde.

Poezia ime është përkthyer në mbi njëzet gjuhë dhe përfshirë në antologji të ndryshme, ndërkaq vepra të mia të veçanta në gjuhë të ndryshme të botës janë: *Exilul Sufletului* (2004), *Schalte das magische Licht ein* (2004), *Only Death is White* (2005), *Ako stanam angel* (2006), *Ploaia fara Tine* (2008), *Beauté maudite* (2010), (2012), *När himlen tystnar* (2012), *Allume la lumière magique* (2012), *Il gioco delle foglie* (2015), (2016), *Albán éjzaska* (2017), *La tono de laamo* (2017), *Whispering agony* (2020).

Mendoj se paraqitja dhe promovimi i suksesshëm i letërsisë shqipe jashtë vendit varet nga shumë faktorë. Kjo ndërlihet me bashkëpunimin e autorëve, përkthyesve, botuesve dhe institucioneve.

Veprat tuaja me poezi, sidomos tri të fundit, po heqim nga ky kontekst përzgjedhjet me poezi që kanë bërë disa përgatitës, kanë peshë më të madhe erotike sesa, ta zëmë, ato të botuara në kohën para luftës. Pse kaq shumë zë vend dashuria në poezinë tuaj, që herë del përemër, herë emër, herë tjetër mbiemër, herë ndajfolje e çfarë jo tjetër, si: ajo, vasha, e bukura, e mira, e ëmbla, e dashura, këmbëshpejta... Pra, kudo është ajo, një vajzë apo një grua, një bukur e nëmur dhe një vdekje e bardhë.

Dashuria është përmbajtja kryesore e jetës së njeriut. Është kuptimi, domethënia dhe kënaqësia e njeriut në këtë botë dhe sigurisht nuk mund të përdoren të njëjtat metafora për dashurinë. Tërë jetën time jam përpjekur ta gjej dhe ta kuptoj burimin e dashurisë, pse mahniten kaq shumë poetët kur shkruajnë

për dashurinë. Kur shkruajnë për familjen, gruan, fëmijët etj. Në poezinë time: bashkëshortja, Drita, fëmijët: Albulena, Besiana, Doruntina, Etleva, Rozafa dhe Rea, pastaj mbesat dhe nipat, janë paraqitur përmes vargjeve të shenjzimit të veçantë shpirtëror, pikërisht aty ku frymojnë bashkë jeta dhe poezia.

Cila drithërimë është më e bukur për ta përshkruar çastin e shpërthimit të ndjenjave sikur të ishte një fushë magnetike, e cila duhet të plotësohet vazhdimisht me ndjenja të zjarra. Kjo është bota e ndjesive për të cilën do të shkruante dhe do të fliste secili poet. Pas leximit të shumë librave të ndryshëm të shkrimtarëve botërorë kam kuptuar se pikërisht kënaqësia e vërtetë e njeriut fillin e ka te dashuria, te pasionet që krijohen me fuqinë dhe praninë e saj. Pra, për dashurinë si ide, shije, koncept, përmbajtje, ligjërim, ndjenjë, përfytyrim, shenjë, mishërim, pasion, magji, ndoshta nganjëherë vetëm vuajtje dhe dhimbje. Shprehjet e zjarra lirike për dashurinë dhe lumturinë mishërohen në jetën shpirtërore. Çdo zotërim i shfaq shenjat e një perceptimi magjik, i cili gjithnjë e fuqizon pasionin aty ku ngjizet mrekullia e përjetimit dhe aventura e imagjinatës. Imazhi i vajzës apo i gruas së bukur mund të jetë projektion i çdo krijuesi jo vetëm në letërsi, por në të gjitha artet e bukura. Prandaj, modeli poetik i dashurisë, i ndërlidhur me figurën femërore, shfaqet midis lumturisë dhe bukurisë, madje përtej gjurmimit të vlerave shpirtërore. Ekuacioni i metaforave për dashurinë si shenjë dalluese midis ndjenjës, përjetimit dhe imagjinatës, ndërlidhet me emocionet që shkaktojnë kënaqësi, aty ku nuk ka tepri të ndjenjave dhe më shumë gjëra të pashprehura apo të pathëna.

Në poezinë time dashuria është prodhim i gjendjes shpirtërore që e ushqen imagjinatën krijuese me ndjenjën e jetës, gëzimit, lumturisë, besimit, virtytit, shpresës, mirësisë etj.

Në disa prej veprave të mia me poezi, *Dalje nga trishtimi, Bukuri e nëmur, Në fillim ishte Drita, Asnjë zë tjetër, Lutja e parë e shpirtit* si dhe në veprat me prozë poetike *Ëndrra në parajsë, Sytë e vetmisë, Zemërimi i heshtjes dhe Shkallët e natës*, një hapësirë të madhe zë tema e dashurisë.

Lumturia e shtrësuar përbrenda meje kishte diçka më të bukur se ëndrrat e dashurisë të cilat sikur i mbaja mend dhe i paraqisja në vargje, duke kuptuar ndjeshmërinë që ishte edhe përtej kësaj përmase. Prandaj, dëshira për ta funksionalizuar ligjërimin poetik, ku dashuria paraqitet si vizion i bukur i jetës, pa dyshim është thelbi i bukurisë që fundja ka të bëjë me magjinë poetike të cilën do ta lakmonin të gjithë poetët.

Asnjëherë s'e kam kuptuar deri në fund ndjesinë e dashurisë. Pse njeriu gjithmonë dashuron, duke krijuar një frymë autentike, kuptohet për ta ndërtuar efektin poetik dhe efektin estetik.

Në prozën poetike përgjithësisht, por edhe në veprat me poezi që i kam botuar në dhjetëvjetëshin e fundit, ka një prani të madhe dimensionit i

përshkrimit të syve. Pasioni për ta shënjuar poetikisht përflakjen e shikimit, në kuptimin për të saktësuar diçka që është e bukur dhe për të krahasuar diçka që është tërheqëse, madje magjike. Gjithmonë synoj t'i konceptoj imazhet e qarta, për ta kuptuar procesin e vazhdueshëm për një përputhje midis kuptimit, domethënies dhe kënaqësisë estetike.

Në poezinë dhe prozën time poetike përdorimi i madh i epiteteve dhe krahasimeve ndërlidhet kryesisht me perceptimin dhe ndjeshmërinë për ta funksionalizuar imazhin simbolik me besueshmërinë imagjinare, të ndërlidhur me përshkrimin e syve, për ngjyrat e tyre, mbase edhe për efektin e shikimit. Kësajsoj, shikimin në sy e kam kuptuar si diçka të jashtëzakonshme. Babai im më thoshte se kur njeriu s'të shikon drejt në sy, sikur fsheh diçka në vetvete, pikërisht në karakterin e tij, në mosguximin e tij, në mosbesimin e tij. Mbese kjo është një pikurë e bukur që shndërrohet me një perceptim shpirtëror, që e ndërton parabolën e vet drejt shtegimit të pasioneve të zjarra për kuptimin dhe domethënien e dashurisë. Në fakt, rrëmbimi dhe fuqia e shikimit është si shtjellimi i një imazhi i cili rikthehet në figurë poetike për ta zbërthyer fshehtësinë e frymëzimit poetik, aty ku portretizohet prania apo edhe mosprania e bukurisë femërore.

Libri poetik *Në fillim ishte Drita*, i cili përbëhet nga nëntëdhjetë e nëntë poezi, e përcakton ndjeshmërinë sublimë për efektin estetik të dashurisë. Elementi i përhershëm dhe kryesor është dashuria njerëzore, ndjesia për të dhe fuqizimi i fjalës dashuri përbrenda reflektimit të saj, edhe si pyetje edhe si përgjigje në sistemin e shenjave shpirtërore. Kësaj radhe po ua lë rendin simboleve, aty ku ritmi, figura, metafora qëndrojnë midis faktit jetësor, faktit letrar dhe faktit estetik. Ekzistenca e dashurisë lidhet me Dritën, që shkon përtej bukurisë artistike për ta mbërritur efektin e ndjeshmërisë poetike si strukturë mendimi dhe si strukturë përjetimi, madje për dashurinë me një kod të ri komunikimi përbrenda kornizës filozofike.

Mendoj se *Në fillim ishte Drita* është një libër mahnitës që e lavdëron dashurinë njerëzore.

Keni disa poezi me motive për dorëshkrimet e djegura, por keni edhe disa poezi me motive për dorëshkrimet e ringjallura. Po ashtu, keni edhe një libër me poezi me titullin 'Dorëshkrimi i ngjallur'. 'Dorëshkrimi i ringjallur', megjithatë, nuk është ai i djeguri. Është tjetër, sigurisht?

Kohën e fundit shkruaj për diçka që nuk ekziston më as si formë as si përmbajtje në horizontin e pritjes së një autori. Cila do të ishte renditja e imazheve që e shënojnë dhe funksionalizojnë botën reale nën ndikimin e boshllëkut dhe mungesës, thuajse po flas tani për historinë dhe legjendën, aty ku rizgohet në kujtesë objekti i perceptimit (shtëpia e djegur bashkë me bibliotekën).

Shkruaj për situatat e dhimbjes shpirtërore apo për paqëndrueshmërinë e ndjenjës. Pa dyshim, ndjenjat bëhen të paqëndrueshme kur i kaplojnë tmerri dhe fatkeqësia. Prandaj, jo rrallë, mërzia bëhet frymëzim kryesor i disa prej poezive të mia, kur shpjegohet mënyra e shenjzimit të fatkeqësisë.

Shkruaj për shkumbin dhe për hirin. Aty kodet e dhimbjes e përmbush boshllëkun dhe humbjen.

Libri poetik *Dorëshkrimi i ngjallur*, ashtu siç thua, nuk është dorëshkrimi i djegur. Është zgjimi nga realja, ndjesia e ikjes të gjërave të dashura, që nuk kthehen më në jetë, por vetëm si imazhe rrokullisen në kujtesën time dhe më duket se po komunikoj me to.

Çdo mëngjes pothuajse e masë dhimbjen time me rrëfimet paralajmëruese për gjërat e dashura e të paharruara, që më nuk i shoh dhe as nuk i prek, por vetëm e ndiej mungesën e tyre në shpirt dhe dua të bëj diçka për to, së paku të shkruaj që të mbesin më shumë si kujtime të dokumentuara. Në fakt, gjërat që nuk ekzistojnë bëhen imagjinatë e padurueshme në kujtesën time dhe shpërthejnë pikërisht me përmallimin e pikëlluar, për ta krijuar ndjenjën e thellë të nostalgjisë për kohën e përjetuar.

Shtëpia e djegur, biblioteka e djegur, dorëshkrimet e djegura, fotografitë e djegura, s'janë vetëm dhimbje, pikëllim, humbje. Është një tronditje shpirtërore për secilin krijues që humb diçka të shtrenjtë dhe të pazëvendësueshme në jetën e tij shpirtërore.

Dorëshkrimi i ngjallur është libër i pavdekësisë së shpirtit, sikundër që është kapërcim i ankthit krijues që e ka poetikën e vet si dëshmi për një kohë. Pa dyshim, i ka ato shenja të biografisë sime shpirtërore që tashmë nuk më takojnë vetëm mua, por edhe të tjerëve. Më vjen mirë që nga juria profesionale e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është nderuar me çmimin vjetor për letërsi si vepra më e mirë letrare në poezi e botuar në vitin 2011. Është nderuar edhe me çmimin kryesor të Mitingut të Poezisë në Gjakovë.

Sali Bashota është një prej poetëve më të veçantë të letërsisë së sotme shqipe, vlerësojnë kritikë të rinj dhe të vjetër, sidomos studiues të poezisë. Poezinë tuaj e kanë vlerësuar me çmime për veprën më të mirë në poezi edhe juritë e Ministrisë së Kulturës të Kosovës, të cilat edhe i falënderuat, por edhe disa shoqata kulturore në Kosovë dhe gjetiu. Çfarë dallon poezia juaj nga e bashkëkohanikëve meqë juritë e dallojnë? Na thoni, pa modesti, pse është më e veçantë?

Më duket se në krijimtarinë time ka më shumë tema të dhimbjes, të trishtimit, të vetmisë, por edhe ironi, paradoks dhe alegori. Mendoj se veprat e mia në poezi iu përkasin tri fazave. Faza e parë: *Albumi i grisur, Zogu me profil*

vjeshte dhe Plagomë; faza e dytë: Dalje nga trishtimi, Bukuri e nëmur dhe Dorëshkrimi i ngjallur; faza e tretë: Në fillim ishte Drita, Asnjë zë tjetër, Lutja e parë e shpirtit dhe Pëshpëritja e agonisë.

Përse këto tri faza?

Ndoshta përbrenda këtyre tri fazave qëndron përkufizimi i vetmisë dhe i dramës shpirtërore të krijesit përballë një realiteti që formësohet e shformësohet me praninë ose mospraninë e subjektit lirik.

Jam përpjekur të jem i veçantë në poezi. Këtë gjë e vlerësojnë të tjerët. I veçantë me lirizmin, ndjeshmërinë, me dhimbjen, me pikëllimin, me ëndrrat, pastaj me gjuhën, ligjërimin, me stilin, me figurat. A kam shkruar përtej këtyre? Prapë e vlerësojnë të tjerët.

Jam përpjekur ta fuqizoj dashurinë për ekzistencën jetësore duke i dhënë përparësi lumturisë për të ngadhënjyer mbi zemërimin, duke e kërkuar burimin e frymëzimeve të mia pikërisht te jeta e njeriut. Mund të jetë ky një rrëfim i çuditshëm dhe i pabesueshëm, por është i sinqertë.

Jam përpjekur të jem i veçantë me ide për ta paraqitur vetminë time krijuese në komunikim shpirtëror me lexuesin, për t'i kuptuar sa më qartë çastet e krijimit dhe dëshirën e fshehtë të frymëzimit, kështu që në mendjen time gjithmonë kam synuar zgjedhjen estetike, për ta ndërtuar, qoftë një peizazh, një gjendje shpirtërore apo një shprehje të çastit.

Të jesh poet i veçantë me ndjenjat, idetë dhe mendimet e tua. I veçantë me jetën dhe shkrimin. Pra, veçantia e përcakton botën emocionale të krijesit, karakterin dhe individualitetin e tij.

Si duket një poet i veçantë kur shkruan në tavolinën e punës pranë kompjuterit, duke ecur rrugëve të Prishtinës, pastaj përpara studentëve duke shpjeguar për letërsinë shqipe, duke bashkëbiseduar me miqtë e vet. Kjo është ajo pjesa që e quajmë, realja.

Miqësia ime me Ibrahim Berishën, Milazim Krasniqin dhe me të ndjerin, Basri Çapriqi, ishte mjaft e rëndësishme për ta kuptuar më qartë botën e letërsisë dhe zbulimin e sfidave krijuese. Përbrenda kësaj miqësie e bashkëndanim suksesin tonë, por edhe të brezit letrar. Kjo është një kaptinë e mrekullueshme për një kohë të gjatë, gati për dyzet vjet, pra një miqësi e mirë, pothuajse, më shumë se gjysma e jetës.

Prandaj edhe brezi im letrar është i veçantë në letërsinë e sotme shqipe edhe me konceptin për letërsinë, për vlerën dhe rëndësinë e saj, për problemet e vlerësimit kritik, për metodat e studimit, për antologjitë letrare, për historinë e letërsisë shqipe etj.

Sot nuk lexoni gjithçka dhe shumë sepse keni punë më shumë sesa që kishit pa u bërë profesor, pa

u bërë bashkëshort, pa u bërë prindër, pa u bërë gjysh. Çfarë lexon Sali Bashota? Çfarë përzgjedh për lexim?

Përzgjedhja për lexim është një tregim më vete dhe, nganjëherë, mund të ketë kundërefekt. Nëse i ke në raftin e bibliotekës veprat e shkrimtarëve më të njohur, mos e përqendro vëmendjen te më i miri, siç thonë të tjerët. Lexoju të gjithë. Këtu fillon ëndrra e lexuesit dhe vdes paragjykimi.

A mund të kemi ide, motive, tema të caktuara për letërsinë. Disa thonë po. Të tjerët thonë jo. Edhe kur i përzgjedhim veprat për t'i lexuar, pa dyshim, e krijojmë bindjen personale për autorin dhe veprën dhe, nëse nuk pajtohem, sikur kemi të bëjmë me një lloj "shpërbërjeje të kujtesës" së leximit. Harold Bloom ka thënë: *Të lexuarit siç duhet arrihet vetëm nëse kryhet si një disiplinë e brendshme; s'ka recetë a metodë përveç vetvetes që derdh, formon, gdhend e lëmon kallëpin e një lexuesi të mirë.*

Mua më pëlqejnë veprat që dallohen për stilin e tyre dhe, natyrisht, kur sintetizojnë prirje letrare, filozofike, psikologjike, ndonjëherë edhe historike. Natyrisht, dëshiroj ta zbuloj të fshehtën e cila më bëhet synim pasionues për të mbërritur në fundin e leximit. Me fjalë të tjera, jo rrallë më ka ndodhur ta filloj leximin e një vepre dhe ta përmbyll komunikimin me të, në njëzet apo tridhjetë faqet e fillimit të saj. Mendoj se përqendrimi apo vëmendja e lexuesit i nënshtrohet instinktit apo dëshirës për përjetim estetik. Situatat e pëlqyeshme apo të papëlqyeshme krijohen nga akti i leximit dhe i përjetimit. Këto janë edhe probleme të imponimit apo probleme të metodës së vlerësimit.

Vitet e fundit lexoj vepra që i zgjedh me pasion të veçantë. Të them të drejtën, çdo ditë lexoj poezi të veçanta të autorëve që më pëlqejnë, të poetëve shqiptarë, por edhe të poetëve botërorë. Më duket se leximi i një poezie apo i një vëllimi me poezi ka një ndikim vendimtar për mua, në radhë të parë, për ta ruajtur vazhdimësinë e leximit edhe të veprave të tjera, kryesisht prozë dhe kritikë letrare.

Leximi i veprave të mira është një gëzim dhe kënaqësi e veçantë, sidomos kur lexoj çdo ditë në orët e hershme të mëngjesit. Kurrë nuk kam lexuar vepra natën. As vetë nuk e di pse më ka ndodhur kjo mospërshtatje me kohën dhe me orarin e leximit. Për më tepër, leximi është një lloj reference për ta ndërtuar një vizion për diçka që e adhuron herën e parë kur gjendesh në pozitën e lexuesit dhe herën e dytë kur je vetë në pozitën e shkrimtarit. Cila do të ishte vlera përcaktuese kur bën gjëra të domosdoshme apo kur bën gjëra të dëshiruara. Mendoj se leximi duhet të jetë detyrim shpirtëror për njeriun. Dhe kjo kërkesë varet se çfarë lexon për t'i thelluar dhe zgjeruar njohuritë e tua.

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia". Vijon në numrat e ardhshëm të gazetës. © Armagedoni").



Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

E paqartë mbetet e ardhmja e Rexhës

Një prej lojtarëve më të mirë në vitet e fundit në futbollin e Kosovës, Kastriot Rexha, ende nuk ka vendosur se ku do të luajë në kampionatin e ardhshëm. “Ende asgjë nuk kam vendosur, kontrata më ka përfunduar me Dritën. Deri në fund të muajit do të vendos se ku do të luaj në të ardhmen”, ka thënë Rexha



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 KORRIK - E ardhmja e sulmuesit Kastriot Rexha vazhdon të mbetet e paqartë. Në fakt, ish-futbollistit më të mirë i ka përfunduar kontrata me skuadrën e Dritës dhe ende nuk dihet se a do ta djersijë Rexha fanellën e skuadrës gjilanasë. I kontaktuar nga “Epoka e re”, sulmuesi Prishtina ka thënë se brenda këtij muaji mund do ta marrë vendimin për të ardhmen e tij. “Ende asgjë nuk kam vendosur, kontrata më ka përfunduar me Dritën. Deri në fund të muajit

do të vendos se ku do të luaj në të ardhmen”, ka thënë Rexha. Ish-sulmuesi i shumë skuadrave në Kosovë ishte lënduar në edicionin e kaluar, që ndikoi edhe në rezultatet e skuadrës së Dritës, e cila nuk arriti ta mbrojë titullin e kampiones në Superligë. Rexha tash ka filluar ta marrë veten dhe lëndimin e pësuar është duke e lënë pas shpinës. “Po ndihem mirë dhe lëndimin po e tejkaloj dalëngadalë. Lëndimi i pësuar nuk ka qenë aspak i lehtë, por jam duke e marrë veten. Kam filluar vrapimin dhe nëse gjithçka shkon sikurse deri tash, do të rikthehem shumë shpejt”, ka shtuar ai.

Skuadra e Dritës e mposhti në raundin e parë skuadrën e Deçiqit, kurse në raundin e dytë do të përballet me skuadrën e njohur holandeze Feyenoord. Sulmuesi Kastriot Rexha e ka komentuar edhe përballet e Dritës me skuadrën holandeze në Ligën e Konferencës. “Të gjithë e dinë kualitetin e skuadrës së Feyenoordit. Drita arriti një sukses dhe tash do të përballet me një skuadër shumë cilësore, vetë fakti se do të përballet me të, është një sukses për Dritën dhe futbollin e Kosovës. Besoj shumë se do të ketë paraqitje të mirë dhe nuk do të koritet”, ka shtuar Rexha.

SHKURT

Khaka pëlqen transferimin te Roma

Granit Xhaka është duke kërkuar seriozisht transferimi te AS Roma. Futbollisti nga Kosova thuhet se ka hequr dorë edhe nga bonuset vetëm që t'i bashkohet skuadrës nga kryeqyteti italian. “La Gazzetta dello Sport” shkruan se 28-vjeçari ka rënë dakord me kushtet e ofruara nga Roma, teksa tani ka mbetur të arrihet një marrëveshje edhe mes klubeve. Problemi i vetëm deri më tani raportohet të jetë çmimi. Romakët kanë ofruar 15 milionë euro, por londinezët janë duke kërkuar së paku 20 milionë. Nëse arrihet edhe një marrëveshje mes klubeve, atëherë Xhaka do të nënshkruaj kontratë katërvjeçare. Granit Xhaka te Roma do të fitonte 2.5 milionë euro në vit.

Uldedaj fiton me nokaut

Çfarë rikthimi në ring për Jurgen Uldedajn. Boksieri lezhjan ishte thjesht fantastik në duelin ndaj ukrainasit Dmitri Serguta të cilin e mposhti me nock-out në raundin e 7-të. Kjo ishte fitorja e 14-t e 23-vjeçarit që bokson në kategorinë “Cruiser”, deri në 90 kilogramë. Uldedaj prej vitesh stërvitet në Gjermani nën urdhrat e trajnerit Dirk Dzemski dhe promotorit më të njohur në Gjermani, Ulf Steinforth. Me kalimin e viteve Uldedaj ka legjitimuar veten si boksieri numër një në peshën “Cruiser” në skenën gjermane të boksit.

Nga 3 deri në 10 euro çmimi i biletave për ndeshjen Prishtina - Connah's Quay

FC Prishtina zhvillon të martën ndeshjen e radhës në kuadër të Conference League. Skuadra e Prishtinës do të përballet me kampionen e Uellsit, Connah's Quay Nomads, nga ora 18:00. Kjo përballet luhet në stadiumin ‘Fadil Vokrri’ në kuadër të raundit të dytë kualifikues të Ligës së Konferencës. Klubi kryeqytetas ka njoftuar se kjo ndeshje do të luhet me numër të limituar të tifozëve dhe kanë bërë të ditur çmimin e biletave. Një biletë në tribunat Jugore dhe Veriore do të kushtojë tri euro, në tribunën Lindore bileta do të jetë pesë euro, ndërsa në atë perëndimore çmimi është 10 euro. Skuadra e Prishtinës synon të marrë rezultat pozitiv me ndihmën e tifozëve në stadium.

Berisha largohet nga Western United

Sulmuesi Besart Berisha i ka dhënë fund aventurës me klubin australian Western United. Përmes një postimi në “Instagram”, 35-vjeçari njoftoi se pas dy sezoneve do të largohet nga ky klub. Faleminderit klubit të futbollit Western United, tifozëve dhe stafit për ato dy sezona të mahnitshme! Ishte një kënaqësi për të luajtur dhe shënua gola për ju! Dua të falënderoj shumë shokët e ekipit, ishte mirë të luaja së bashku me ju”, ka shkruar Berisha në llogarinë e vet zyrtare në “Instagram”. Në 48 ndeshjet e zhvilluara për Western United, Berisha ka luajtur në 48 ndeshje duke realizuar 26 gola dhe duke bërë tri asistime. Në 48 ndeshjet e zhvilluara për Western United, Berisha ka luajtur në 48 ndeshje duke realizuar 26 gola dhe duke bërë tri asistime.

Salihu: Të premtën inaugurohet shtatorja e Fadil Vokrrit

PRISHTINË, 18 KORRIK - Shtatorja e ish-presidentit të Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri, do të inaugurohet të premtën më 23 korrik në stadiumin e Prishtinës nga ora 18:00. Këtë lajm për

“KosovaPress” e ka konfirmuar sekretari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Eroll Salihu. “Shtatorja e Fadil Vokrrit do të inaugurohet të premtën më 23 korrik”, ka thënë Salihu. Ai tregoi se menjëherë pas

ceremonisë së zbulimit të shtatorës, në stadiumin “Fadil Vokrri” do të zhvillohen edhe dy ndeshje miqësore. Aty do të përballet veteranët e Kosovës dhe të Shqipërisë dhe, po ashtu, skuadra Prishtina 1991

dhe Llapi. “Do të zhvillohen edhe dy ndeshje miqësore menjëherë pas ceremonisë. Do të përballet edhe veteranët e Shqipërisë dhe të Kosovës si dhe skuadra e Prishtinës 1991 dhe Llapi”, ka shtuar Salihu.



Kosova A në konkurrencën e femrave të martën debuton në garat ndërkombëtare

PRISHTINË, 18 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll është gati të garojë në Evropë. Kosova për herë të parë në histori do të garojë me basketbollistët seniorë në

ndonjë garë ndërkombëtare. Vashat e Kosovës tashmë janë nisur për në Qipro, ku do të mbahet Kampionati Evropian për Shtete të vogla nga 20 deri më 25 korrik. Kosova është në

grup me Qipron dhe Luksemburgun, ndërsa ndeshjen e parë debutuese e luan ndaj Qipros të martën. Gjatë ditëve të fundit basketbollistët e vendit tonë

janë vizituar në stërvitjet e tyre nga përfaqësues të shtetit si presidentja Vjosa Osmani që i motivoi dhe u dha mbështetje lojtarëve para çastit historik.



Milwaukee, një fitore larg historisë

MILWAUKEE, 18 KORRIK - Milwaukee Bucks vetëm një fitore larg historisë. Pas 50 vjetësh Giannis Antetokounmpo me shokë mund ta rikthejnë titullin kampion të NBA-s në Wisconsin. Milwaukee Bucks bëri përmbysjen e madhe në serinë e finaleve të NBA-s ndaj Phoenix Suns duke fituar ndeshjen e tretë radhazi këtë herë brenda në Arizona për ta marrë kryesimin 3-2 me ndeshje. Një sukses me shifrat e ngushta 123-119 për Bucksin që e nisi si mos më keq ndeshjen, por arriti t'i përmbysë shifrat në periodat 2 dhe 3 duke menaxhuar më pas avantazhin. Davon Booker realizoi 40 pikë për Phoenix Suns duke rezultuar pikëshënuesi më i mirë i sfidës, të pamjaftueshme gjithsesi për ta evituar humbjen e skuadrës së trajnerit Monty Williams. Në krahun tjetër u shfaq në superformë treshja Giannis Antetokounmpo, Khris Middleton-Jrue Holiday. Greku i cili me një zhytje fantastike realizoi edhe koshin që vendosi fatet e takimit pak sekonda para fundit, spikati me 32 pikë, 9 rebounde e 6



asistime, ndërkohë Middletoni shtoi 29 dhe Holiday 27 të tjera në këtë fitore të madhe të skuadrës së Mike Budenholzerit. Ndeshja nisi me Phoenixin në superformë pasi ekipi vendas e mbylli periodën e parë me një rezultat të pjesshëm 37-21 në favor, diferencë që dukej se do të ruhej deri në fund, por perioda e dytë ishte vërtet katastrofike për Suns-in i cili lëshoi shumë terren me Milwaukee që realizoi 19 pikë më shumë vetëm në këtë 12-minutësh, duke shkuar

në pushim me avantazhin e tri pikëve. Edhe perioda e tretë foli për Bucksin i cili e thelloi epërsinë në +10 në fund të këtij 12-minutëshi. Në periodën e 4-t dhe atë të fundit Phoenixi u përpoq të rikthehej në ndeshje, por vetëm sa ngushtoi diferencën deri në -1 pikë sepse festa në fund ishte e gjitha për miqtë që ndeshjen e 6-të do ta luajnë në Wisconsin dhe do ta kenë mundësinë që në rast triumfi ta ngrenë lart trofeun e kampionës së NBA-s.

Sarri nuk lejon tifozët ta kritikojnë Muriqin

ROME, 18 KORRIK - Vedat Muriqi më 15 shtator të vitit 2020 u largua nga Fenerbahçe dhe për 18.5 milionë euro duke iu bashkuar Lazio. Ishte hapi më i madh në karrierë për futbollistin e përfaqësueses së Kosovës, i cili, pas një sezoni shumë të mirë në Turqi, do të provonte në Serinë A. Përshtatja nuk ishte e thjeshtë edhe nga fakti se Muriqi e humbi muajin e parë te Lazio sepse ishte i infektuar me koronavirus e më pas, dalëngadalë, u mundua të integrohej, por sërish e mbylli me pak gola të shënuar, vetëm 2 në 34 paraqitje. U përfol për një largim të tij nga bardhekaltrit, por trajneri Sarri e përfshiu menjëherë si pjesë të projektit të tij dhe së fundmi e ka mbrojtur edhe më tepër sulmuesin 27-vjeçar. Mësohet se gjatë një seance stërvitore në Auronzo di



Cardore, aty ku Lazio po zhvillon fazën përgatitore, Sarri u është kthyer disa tifozëve, duke u thënë shprehimisht: "Nëse ju dëgjoj që kritikoni Muriqin, do t'ju nxjerr jashtë". Pak fjalë, por shumë domethënëse, që tregojnë se ish-

trajneri i Napolit e Juventusit e ka shumë në konsideratë gjigantin nga Prizreni dhe ekziston mundësia që ta aktivizojë edhe më tepër Muriqin, me shpresën që sezoni i ri të jetë më i mirë se ai i pari me fanellën e Lazios.

SHKURT

Lojërat Olimpike në Tokio, 2 atletë preken nga Covid-19

Organizatorët e lojërave Olimpike të Tokios kanë raportuar rastet e para me Covid-19 në mesin e atletëve në fshatin olimpiq. Dy atletë në fshatin Olimpik dhe një tjetër që nuk po qëndron në këtë fshat kanë dalë pozitivë me koronavirus, thanë organizatorët, duke mos dhënë detaje lidhur me atletët e infektuar. Më pak se një javë para nisjes së Olimpiadës janë rritur shqetësimet se si organizatorët do ta menaxhojnë virusin pasi ka një fluks atletësh, staf mbështetës dhe personel tjetër që ka ardhur nga jashtë.

Haalandi: Largimi i Sanchos më trishti

Erling Haaland kishte një lidhje të veçantë me Jadon Sancho. Lojtari anglez u transferua te Manchester Unitedi, lëvizje që e ka mërzhitur bomberin e njohur norvegjez. "E trishtë që u largua Jadon Sancho, por kështu është futbollit. Ne kurrë nuk e dimë se çfarë do të ndodhë në të ardhmen, sidomos në këtë sport. Mendoj se në skuadër ka edhe të tjerë lojtarë me të cilët ndihem mirë dhe rehat. Të shohim se me cilin do të kem 'feeling' më të mirë", ka thënë Haaland. Ndërkohë, Dortmundi është afër blerjes së Donyell Malen. "Ekziston një probabilitet i lartë që një lojtar i ri do të vijë", ka theksuar Michael Zorc, drejtori sportiv i verdhezinjve. 22-vjeçari holandez aktivizohet në majë të sulmit. PSV kërkon 30 milionë euro për ta lënë të lirë, ndërsa klubi gjerman shkon në 25 milionë të tilla. Pajtimi është afër.

Ballo-Toure paraqitet te Milani

Milani ka njoftuar zyrtarisht nënshkrimin me mbrojtësin Fode Ballo-Toure nga Monaco. Mbrojtësi senegalez nënshkroi marrëveshjen në Casa Milan këtë mëngjes me Rossonerët që duhet të paguajnë 4.2 milionë euro plus 500 mijë të tjera bonuse për skuadrën e Ligës 1. Ballo-Toure pritet të jetë alternativë e Theo Hernandezit në të majtë të mbrojtjes së skemave të Stefano Piolit. Transferimin e lojtarit e ka konfirmuar vetë klubi kuqezi me anë të faqeve të veta zyrtare. "AC Milan është i kënaqur ta ëjtoftë për nënshkrimin e përhershëm të Fode Ballo-Toure nga AS Monaco. Mbrojtësi ka nënshkruar një kontratë me Rossonerët deri më 30 qershor 2025 dhe do ta veshë fanellën me numrin 5", thuhet në njoftimin e Milanit.

Edhe dy futbollistë të Spezias infektohen me Covid

Klubi italian po përballet me probleme të shumta. Në ditët e fundit kanë 'shpërthyer' rastet e infektuar me virus në skuadrën e Spezias. Klubi të shtunën informoi se janë infektuar gjashtë futbollistë dhe një anëtar i stafit. Ndërsa në analizat e bëra sot kanë rezultuar edhe dy lojtarë të tjerë pozitivë me Covid-19. Skuadra italiane ka ndërprerë parapërgatitjet që ishin duke i bërë lojtarët para fillimit të sezonit të ri dhe janë futur të gjithë në izolim. Futbollistët janë duke u stërvitur vetëm individualisht në mënyrë që ta ruajnë formën fizike.

E ardhmja e Icardit varet nga Ronaldo

Mauro Icardi dëshiron të rikthehet në Itali dhe Juventus është destinacioni i tij i preferuar. Icardi në Paris nuk arriti kurrë të linte gjurmë, për këtë arsye kërkon të rikthehet sërish në Serinë A.

Roma, gjithashtu, është e interesuar për shërbimet e sulmuesit argjentinas, por në mendjen e tij ekziston vetëm Juventus. Kjo mbetet një tratativë e vështirë, por sigurisht jo e

pamundur. E ardhmja e Icardit është e lidhur ngushtë me atë të dy yjeve të tjerë, Kylian Mbappe dhe Cristiano Ronaldo. Nëse Mbappe largohet nga PSG atëherë klubi francez do të përpiqet ta afrojë

Ronaldon. Për të arritur te portugezi, Leonardo është i gatshëm të sakrifikojë Icardin, një lojtar që përfiton 9 milionë euro neto, shifër të cilën vetëm Juve mund ta përballojë, mbi të gjitha

nëse largohet Ronaldo. Sipas "Corriere dello Sport", përfaqësues të Icardit kanë zënkuar në Torino përpara disa ditësh për të kuptuar nëse Allegri do ta preferonte në skuadër.

FTESË PËR OFERTË

datë:19.07.2021

"EBE" SH.P.K.

Tel.+38349207580

e-mail:q.hoti@yahoo.com

NUI.811150614

Adresa"objekti afarist "DARDANIA",rruga "R. Kombëtare",pn.,Malishevë

Objekti I kontratës:"Improved competitiveness of fruits producers through establishment of the collection centre for fruits respecting related EU standards"

Të nderuar Zonja/zotëri, "EBE SH.P.K. ju fton që të paraqitni ofertën tuaj për zbatimin e projektit të bashkë financuar nga EU dhe EBE sh.p.k., "Improved competitiveness of fruits producers through establishment of the collection centre for fruits respecting related EU standards", loti 1, Loti 2, Loti 3, Loti 4, Loti 5, Loti 6

Kriteret e përzgjedhjes:Tenderi me çmimin më të ulët

Kontrata do të konsistojë në kryerjen e furnizimeve dhe shërbimeve për implementimin e projektit të lartë cekur

Lloji I kontratës:Furnizim dhe shërbime

INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

Afati I fundit për pranimin e kërkesave për dosje data:30.07.2021

Dokumentet për ofertim mund të merren në formë elektronike në adresën,

q.hoti@yahoo.com

Afati kohor për pranimin e ofertave: data 02.08.2021, deri në orën 13, vendi në objektin afarist

Daradania në rrugën Rilindja Kombëtare pn, Malishevë.

Ofertat e sjellura pas orës 13 nuk do të pranohen.

Takimi për hapjen e ofertave: data 02.08.2021, koha 13:30h, vendi në objektin afarist "Dardania" në rrugën "R. kombëtare" Malishevë.

Vlerat e parashikuara :

Loti 1, certifikimi me HACCP, vlera 3,000 €**Loti 2, furnizimi me piruner dore, vlera 2,000.00€****Loti 3, furnizimi me arka PVC për pemë, vlera 16,500.00€****Loti 4, furnizimi me karroca për bartjen e arkave, vlera 4,500.00€****Loti 5, furnizimi me sistem të energjisë solare, vlera 25,600.00 €****Loti 6 , realizimi i auditimit, vlera 2000€**

informacionet plotsuese nga data 22.07.2021 deri me datën 27.07.2021 gjat ditëve të punës

INVITATION OFFER

Date:19.07.2021

"EBE" LLC

Tel.+38349207580

e-mail:q.hoti@yahoo.com

UIN.811150614

Address "DARDANIA" Building, street "R. Kombëtare", pn., Malishevë

Aim of the contract:"Improved competitiveness of fruits producers through establishment of the collection centre for fruits respecting related EU standards"

Dear Mr/Mrs

"EBE" LLC. Invites you to present your offers for the execution of the the project co founded by EU and EBE LLC for : "Improved competitiveness of fruits producers through establishment of the collection centre for fruits respecting related EU standards", lot 1, Lot 2, Lot 3, Lot 4, Lot 5, Lot 6.

Selection Criteria: The lowest price tendering

The contract will consist of services and supplies for the implementation of the above mentioned project

Type of contract: services and supplies

Administrative information

The deadline for submission of requests and bid offers is on: 30.07.2021

The tendering documents can be received via electronic at: q.hoti@yahoo.com

Deadline for receiving offers: date 02.08.2021 to 13:00 Am in the building "Daradani" street "R. Kombëtare" Malishevë.

Offers submitted after 13:00 Am will not be accepted.

Meeting for the opening of the offers : date 02.08.2021 , time 13:30 Am, building locatin

"Dardania" street "R. Kombëtare" Malishevë

The estimated value of the lots:

Loti 1, HACCP certificate, value 3,000 €**Loti 2, purchase of the mechanical fork for the collection centre , value 2,000.00€****Loti 3, purchase of boxes for collection fruits, value 16,500.00€****Loti 4, purchase of applet for conveyance of boxes, value 4,500.00€****Loti 5, Purchase of solar energy system, value 25,600.00 €****Loti 6 , expenditure verification /audit, value 2000€**

Additional information on: 22.07.2021 to 27.07.2021 during working days.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ "3 MIX" SH.P.K. me nr. 810774655 bënë zvogëlim të kapitalit nga 950.000.00 në 5.000.00.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

